

Procesverbal

Nga seanca e VIII-të (tetë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 05.09.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e VII-të e Kuvendit...,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Dragashit,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje/2018-2021,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore-2018,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për dhënien e Pëlqimit për instalimin e teknologjisë "Vivawe-Group" (SHBA), për prodhimin e energjisë me erë, në KK të f.Zgatar,
6. Formimi i Komisionit Komunal për themelimin e këshillave të fshatrave,
7. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Komunal 01 Nr.060-01-9741/5, dhe
8. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...?

z.Vehbi Nazifi- Kërkoj që pika e 8-të e rendit të ditës...të heqet nga rendi i ditës së seancës së Kuvendit dhe të lehet për seancë tjetër, pasi se kërkon informata shtesë.

z.Laurat Krasniqi- Lidhur me kërkesën e kolegut, mendoj se Vendimi i MAPL-së është tejet i qartë, pasi se është thënë se Kuvendi ka vendosur në kundërshtim me ligjet, që theksohet detalisht e pshshtei lokal na ka "gjuajtur topin" neve-si Kuvend. Kështu ne kemi rënë nën ndikimin kryetarit, pasi se nuk kemi të drejtën të japim leje të tilla. Këtë e kam theksuar edhe në seancën e kaluar e që nuk e kemi marr parasysh, dhe tani nuk ka nevojë që ajo pikë të heqet, por të diskutohet, pasi se pa diskutim nuk ka zgjidhje.

z.Vehbi Nazifi- Nevoiten informata shtesë, pasi se duke pasur parasysh se nuk kemi PUrbanistik, kemi të drejtën të bëhen korigjime të caktuara. Kërkesa e pronarit është e qartë dhe, ndoshta , DUrbanizmit ka gabuar dhe, për këtë, nevoiten informata shtesë dhe ne, nuk kërkojmë që të heqet përgjithmonë, por të shtyhet, deri të sigurohen të dhëna shtesë.

Kryesuesi- Në rregull, pasi se nuk kemi edhe diçka, kalojmë në votim të rendit të ditës-pa pikën e 8-të, dhe kush është "për"-21, "kundër"-1 dhe i "përmbajtur"-1.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse jo, miratojmë, pa vërejtje, Procesverbalin.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Pra, vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin e Shqyrtimin dhe Miratimin e Planit për Transparencë për Komunën tonë, që është praktikë e shqyrtimit dhe miratimit, për çdo vit, nga Kuvendi.

z.Laurat Krasniqi- Lidhur me këtë pikë, po theksoj se tek angazhimi i ekzekutivit vërhet përmirësim dhe në disa çështja është më transparent, që, pra, për disa çështje mund të jemi të kënaqur e për disa ka dilema, siç janë konkurset i punësimeve. Gjatë mandatit tim, si delegat, janë hapur dy konkurse për vende pune. Më 06.04.2018 është hapur konkursi për Shërbimin Social dhe i njëjti është publikuar në web-faqe, kurse, për zyrtarin për vetëdijësim, konkursi nuk është publikuar në web-faqe?! Prandaj, kur kandidari i interesuar për atë vend pune ka shkuar në Zyrën Kadrovike, i kanë thënë se nuk ka konkurs?! Pra, ky konkurs është manipuluar dhe, paraprakisht, është ditur individ-i ja e cili-a është pranuar! Në njerin nga konkurset është pranuar punëtori e në atë që është publikuar nuk është pranuar punëtori?!

z.Samidin Xheladini- "Objektivat e Planit të Veprimit për Transparencë te nr.1 dhe 2, që qëndrojnë si tekst, janë në rregull, edhe pse ka disa lëshime në veprime në disa raste në përgjithësi. E treta-konsultimet me publikun, planifikohet që Komuna të organizoj konsultime të ndryshme që janë në interes për qytetarët, si ato për zhvillim lokal, për buxhetin lokal, planifikim hapësinor dhe investime, për të hyrat lokale dhe konsultime për çështje tjera që janë në interes të Komunës dhe që janë investues të jashtëm, ku, në këtë të fundit, nuk ka ndonjë plan se kur dhe si do të bëhet kjo gjë, si dhe vendi dhe aktivitetet që do të mbahen, pra këto rubrika janë të zbrazëta? E katërta-takimet me publikun, siç e dim, në komunën tonë mbahen dy takime të tilla me publikun e që duhet të inkorporohen të gjitha çështjet me interes të përgjithshëm dhe lokal të prezantuara nga individ apo grupe të qytetarëve dhe, këto propozime, deri tani, në masë të madhe, nuk janë marr parasysh, edhe pse mund të janë në interes të madh për komunën tonë, se ku duhet të investohet. Por, në praktikë, deri tani, ka ndodhur e kundërta dhe këto propozime nuk janë inkorporuar në planifikimin e buxhetit. E pesta-Takimet dhe intervistat e kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ dhe gazetarë, ku planifikohen ato takime e, në formë debati, të parashihet në sallën e Kuvendit të Komunës dhe a ka plan që ato të shtohen në çdo lokalitet, veç e veç? E gjashta- E drejta e qasjes në dokumentet publike, komuna obligohet që, brenda 7 ditëve, duhet të jap përgjigje-me shkrim për leje të qasjes në dokumente zyrtare në dokumentacion që është kërkuar, ose të japin me shkrim arsyen e e refuzimit e plotë apo të pjesëshëm, që duhet të informohet kërkuesi për të drejtën e tij. E shtata-Kërkesa për informim,

iniciativat qytetare dhe peticion, edhe kjo mendoj se është e qëlluar, por vetëm për t'u shënuar në letër, sepse, nga praktikat e deritashme, kemi pasur heshtjen e peticioneve dhe asgjë nuk është vepruar në praktikë. E teta- publikimi i akteve komunale, këtu duhet të kemi në konsideratë që, çdo ditë, të publikohen në web-faqen e Komunës dhe në afat ligjor. Këtu duhet të jepet hapësirë edhe publikimit në radiot lokale. E nënta- Freskimi i web-faqes pretendohet që kjo faqe të jetë e lehtë për shfletim dhe kompatible me shfrytëzuesit e internetit. Këtu dua të shtoj se duhet të jepen informata se si qytetarët duhet të hyjnë në faqen zyrtare dhe procedurat si duhet t'i ndjekin ato. E dhjeta- Qasja e shërbimeve për qytetarë të jetë transparente dhe shpejtë. Kjo ,në shumë raste, nuk ndodh edhe si pasojë e mungesës së internetit nëpër zyrat e zyrtarëve komunal. E njëm dhjeta- Prokurimi të jetë transparent dhe uroj që, në të ardhmen, të marrin tenderë ata që janë serioz e jo ata që kanë qenë finansier të fushatave zgjedhore e militant partiak, apo servil të pushtetit("Radio Sharri"). Në fund, uroj që ky Plan të zbatohet në tërësi dhe të pasurohet edhe me veprime tjera konkrete dhe me kyqjen e mediave lokale të cilat do të jepen hapësira të mjaftueshme për informim të shpejtë dhe më të mirë të qytetarëve".

z.Zaim Hajredini- Fjala transparencë, në Komunën e Dragashit ka marr rëndësi të posaçme, për dallim nga vitet e mëparshme e këtë e them në aspektin pozitiv, pasi se gjërat po përmirësohen gradualisht. Por të themi se gjendja është shkëlqyeshme, nuk është e kjo nuk është vetëm në Komunën e Dragashit, por gjithkund në Republikën e Kosovës. Kur falsim për transparencën, në veçanti në llogaridhënie, mund të themi se ekzistojnë mjaft gjëra të cilat ndikojnë pozitivisht në Komunë dhe te ne që miratojmë vendime të rëndësishme ligjore. Është tejet me rëndësi që të kemi një Plan të Transparencës dhe se, në atë drejtim, është punar dhe tani kemi një bazë ligjore e cila do të na udhëheq për të dhënë kontributin për vendin tonë e komunën për interesa të qytetarëve. Ajo që më së shumti më brengos është implementimi i këtij Plani dhe parashtrahet pyetja se sa ne, si Komunë, do të jemi të gatshëm t'a realizojmë atë që sot e votojmë. Faktori për impelementim të sukseshëm të këtij Plani nuk është vetëm Komuna, apo organet e komunës, por edhe qytetarët e kësaj komune të cilët, në njëfar mënyre, nuk janë gjithaq të interesuar e që vetëdijesimin duhet ngritur në nivel më të lartë. Kjo ka mund të shihet nëpër debatet tona publike me (mos) prezencën e qytetarëve në to. Mendimi im është se duhet shtuar nivelin e bashkëpunimit me këshillat lokale. Sa i përret informimit nga Komuna, përmes informatave publike, mendoj se edhe kjo është në nivel, pasi se tani kemi publikime të konkurseve që publikohen në web-faqen e Komunës dhe radiove lokale e ne duhet t'i përkrahim sa më shumë mediat të cilat i japin kontribut informimit të qytetarëve. Vitin e kaluar kam kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të njofton sa më shpesh për proceset e realizimit të tenderëve për firmat të cilat i kanë fituar tenderët, që ne, si delegatë, të dijmë se çka po punohet dhe deri ku është arritur, sepse, tek e fundit, ne jemi organ i cili e miraton buxhetin dhe kërkojmë realizimin e tij e, në këtë drejtim, kontributin e tij duhet të jep edhe kryetari, që të informohemi ne - si Kuvend, nga ana e kësaj Zyreje.

z.Nexhat Isufi- Vet fjala transparencë nënkupton se nuk duhet punuar msheftas dhe se cili qytetar i ynë duhet të dij se çka punon i zgjedhuri i tyre, duke filluar nga kryetari e deri te delegatët e

Kuvendit. Me këtë Plan, mund të konstatoj se në Komunën tonë po shtohet transparencja e që mund të them se për disa çështje transparencja është shtuar në nivel të kënaqshëm. Ndonjëherë madje them se mos jemi bërë shumë transparente se sa shtetet më demokratike dhe unë, vitin e kaluar, kam thënë se, kur është në pyetje transparencja e buxhetit, Komuna të njoftoj sa më shumë qytetarët, pasi se nëpër takimet publike vijmë nga 3-4 përfaqësues të fshatrave e pastaj po na del se pushteti lokal dhe ne delegatët po kemi vërejtje në buxhet, në realizimin e projekteve etj. Ndoshta mos është më mirë që pushteti ekzekutiv, gjatë kësaj periudhe kohore, gjatë 3-4 muajëve të shpërndarjes së buxhetit të del në terren për vizita fshatrave dhe që në vende të caktuara të këshillojë të fshatrave të mbahen mbledhje e të shfaq me qytetarët se cilat janë kërkesat kryesore të tyre për investime kapitale. Ate që e thash në fillim, se ne jemi bërë komunë më transparente, këtë e thash nga arsyeja e vetme e në pyetje është konkursi cili do qoftë dhe, nëse parashtrijmë pyetjen, se çka është transparencja mendoj se, me rastin e publikimit të konkurseve. të shkruhet edhe emri i kandidatit i cili do të pranohet! Këtë e them se kur tani po flasim për transparencën, të gjithë e dinë se kush do të pranohet në punë sipas konkursit! Unë këtë e kam dëgjuar personalisht nga njerëzit që punojnë në Komunë dhe nga qytetarët e zakonshëm dhe jam befatur se nga po i marrin ato informata e lidhur me këtë unë madje kam edhe gjirimin. Tani, para një kohe, kemi pasur konkursin në arsim dhe transparencja e transparencja është të pranohet ai i cili ka qenë më i miri e jo sa për të qenë në letër e nuk guxohet të kënaqen dëshirat partiake e unë jam këtu që të flas për këto gjëra, pasi se e kam fituar besimin e popullit. Në këtë drejtim, edhe një herë, po theksoj se në konkurse është dashur të jenë e dhe emrat e atyre që do të pranohen?!

z.Munir Jonuzi- Sa i përket transparencës, unë do të ndalem te pika 9 e cila flet për mirëmbajtjen e web-faqes komunale dhe dëshiroj të lus pushtetin ekzekutiv që në atë të figurojnë edhe disa kategori, siç kemi: KPFinanca dhe KKomunitete, që të jenë edhe informatat nga këto komitete, siç janë rendi i ditës dhe procesverbalet. E dyta çështje është vendosja e kategorisë së gjuhës boshnjake e aty janë disa gjuhë, si: shqipja, serbishtja, anglishtja, turqishtja, pasi se kështu do të respektonim Statutin tonë, ku në nenin 6 theksohet se gjuhë zyrtare janë: shqipja dhe ajo boshnjake. Mendoj se kjo nuk është vështirë për administratorin tonë të web-faqes, pasi se në pyetje është vetëm dëshira e mirë e pushtetit ekzekutiv. Për këto çështje, vetë komunat mund të bëjnë ndryshime, si dhe nuk e di se a mirëmbahet faqja e Komunës sonë përmes "facebookut" e që mendoj se edhe ajo faqe duhet të jetë dy gjuhësore. Pra, transparencja është tejet me rëndësi për komunën tonë, pasi se në takimet tona që i ka organizuar AKK ata na kanë kritikuar mjaft për këto gjëra, duke na thënë se për këto shkaqe mund të humbim mjaft investime dhe projekte, nëse nuk jemi transparent.

z.Naser Myrtezani- Te pika e dytë e rendit të ditës, apo te çështja e punësimit, ne si parti politike dhe delegat (LDK) kemi vërjetet tona, pasi se punësimet, edhe kësaj radhe, nuk kanë qenë transparente në arsim, duke u pranuar punëtorët-votues të partisë në pushtet. Kemi vërejtje se në fshatra të caktuara askush nuk është pranuar në punë nga ai fshat, që konkretisht kemi rastin në Zaplluxhe, ku nuk është punësuar askush në asnjë sektor?! Kemi pasur mjaft konkurse nga fshati Zaplluxhe, për në arsim e që kanë qenë student të mirë, e askush nuk është pranuar e që kemi pasur

raste të vlerësohen, me një poen më pak, nga ata që janë pranuar në punë?! Kjo na detyron që të dyshojmë se sa ky proces ka qenë transparent dhe kërkojmë të jeni transparent me rastin e punësimit e që t'a keni në dijeni, për të mos punuar sipas përcaktimeve politike.

Kryesuesi- Në rregull, tani kalojmë në votim dhe kush është "për"-20, "kundër"-0 dhe 3 vota "të përmbajtura", që, pra, miratohet kjo pikë e rendit të ditës-Plani i Transarencës.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe në kuadër të kësaj pike, prap, tani e kemi shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Veprimit Kundër Dhunës në famulje i cili është dërguar nga ZÇGjinore, për periudhën 2018-2021, hapim diskutimin.

z.Lindita Piraj (ZÇgjinore)- Ky Plan bazohet në Planin nacional për Luftën Kundër Dhunës në Familje dhe, siç e shihni, Plani përfshin mjaft aktivitete me 3 qëllime kryesore. Qëllimi kryesor është senzibilizimi i komunitetit kundër këtyre dukurive dhe mbrojtja e viktimave, si dhe integrimi i tyre në shoqëri normale. Në këtë Plan kemi shuma simbolike që kërkohen nga ana e Komunës e pjesën më të madhe të shpenzimeve e bartin donatorët dhe ministritë kompetente. Edhe pse këto janë shuma simbolike të cilat kërkohen nga ana e Komunës. Ato, gjithsesi, janë të nevojshme, që të na përkrahin donatorët. Këto janë aktivitete të cilat, në periudhën e ardhshme, do të realizohen nga Mekanizmi për Luftën Kundër Dhunës në Familje i cili është themeluar në vitin 2012 e që ky vepruar, kryesisht, me përkrahjen e OKB-së e, kohëve të fundit, më së shumti, jemi përkrahur nga organizata UNWomen. Ky Plan dhe veprimi i këtill është njëri nga standardet i cili kërkohet nga BE-ja nga vendi ynë, si dhe nga komuna jonë. Dua vetëm të përmirësoj një pikë ku flitet për printimin e posterëve, fletpalosjeve, fanelave etj. që do të mbulohen nga Komuna e Gjilanit dhe këtu që shkruan ashtu, nuk është "gabim teknikë", pasi se ne si Komunë, jemi në bashkveprim me komunën e Gjilanit dhe Gjakovës në programin e përbashkët, me aktivitete të përbashkëta, pasi se Komuna e Dragashit e ka buxhetin e vogël, Komuna e Gjilanit e ka marr obligimin e sigurimit të këtyre materialeve që nevojitet gjatë fushatës senzibilizuese të popullatës e ne, për këtë, nuk do të krijojmë shpenzime shtesë.

z.Samidin Xheladini- Do të ishte më së miri të na i kishit dhënë mënyrat e vperimit, finansimit dhe organizimit të trajnimeve, që do të bindeshim më mirë për përkrahjen e këtij Plani. Ju, gjithësesi, e keni përkrahjen tonë në këtë luftë kundër dhunës në familje, por pa rezervë, nga se ka paqartësi të caktuara. Ne vetëm dëshirojmë të jemi të sigurt që me rastin e elaborimit të këtij dokumenti, mos të bëjmë gabime, pasi se, siç po shihet, fleta e parë ka shumë më pak hargjime se e dyta. Prandaj, duke pasur parasysh se keni pasur vizita të caktuara studimore e që kanë marr pjesë anëtarët e Mekanizmit Komunal, e po flitni se janë të kyçur edhe persona nga Qendra për Punë Sociale dhe DSHëndetësisë, në ngritjen e vetëdijesimit. Po ashtu, në fund, kemi shumë prej 13 mijë eurove se ato qenkan siguruar e alokuar dhe a janë ato mjete të vitit vijues apo vitit tjetër? Për lëtë duhet të na njoftoni sot, pasi se

nuk i dijmë rezultatet konkrete që i keni arritur në këtë lëmi, si dhe faktin se mediat nuk janë të kyçura fare në këtë proces?

z.Arjeta Skeraj- Ne, si Komunë e vogël, nuk kemi shumë raste të dhunës në familje, por kemi raste të evidentuara dhe ato raste që janë duhet t'i marrim parasysh. E dyta, ne që sot e kemi këtë në rend dite, më vjen mirë që e përkrah Komuna, që mendoj se, në të ardhmen, do të jetë mirë për Komunën. Duke e lexuar këtë Plan, unë vërejtja se 5 mijë nxënës qenkan njoftuar me dhunën në familje, përfshirë këtu edhe 500 mësimdhënës dhe 80 punëtorë shëndetësor e kjo është mirë që rastet e dhunës në familje të paraqiten, në radhë të parë, në institucionet shëndetësore e që për rastet e këtilla të ofrohet ndihmë juridike - pa pagesë. Po ashtu, përmendet dhënia e subvencioneve për rastet e dhunës familjare, që pra është mirë të bëhet shfrytëzimi i subvencioneve, për këto raste, nga ana e viktimave të dhunës familjare.

z.Zaim Hajredini- Është evidente se lidhur me çështje të caktuara nuk jemi të informuar sa duhet e për t'u punuar reth këtyre çështjeve nevoiten më shumë mjete. Unë jam i informuar për këto veprimtari, nga se kam qenë i kyçur që nga fillimi me "pilot-projekte" dhe kur e kemi themeluar këtë Mekanizëm të gjithë kemi qenë prezent, si kolegu ynë Samidin Xh. e që kemi pasur strategji të mirë, por shumë pak mundësi. Siç e dini, atëherë nuk na është lejuar të finansohemi nga buxheti përmes Komunës. Por, Komuna ka dhënë kontribut maksimal përmes transportit etj. dhe mendoj se këto çështje duhet trajtuar seriozisht. Ky Plan i Veperimit është hartuar për periudhën 2018-2021 dhe ka parapar aspekte të caktuara e puna më e madhe finansohet përmes donatorëve. Kërkesa kryesore e donatorëve është që të bëhet sufinansimi nga Komuna i projekteve të caktuara, sepse, nëse ata janë të gatshëm të bëjnë diçka, këtë e kërkojnë të përkrah edhe Komuna. Shuma që kërkohet për finansim nga Komuna është simbolike-diku 4 mijë euro në vit. Po ashtu, kërkohet nga pushteti qendror sigurimi i një kodi të posaçm buxhetor për barazi gjinore, që ky qëndrim ende nuk është realizuar. Pasi se mjetete janë simbolike, për 3 vite të aktivitetit, duhet të jemi më shumë kooperues. Është lehtë të mabehen kurse e trajnime të caktuara, por problemet është që të integrohen viktimat e dhunës familjare, pasi se nuk kemi se ku t'i vendosim e punësojmë. Dhe e jona është që t'i njoftojmë qytetarët se ekziston Mekanizmi i cili është në rolin e mbrojtësit të qytetarëve të këtill, edhe pse mendojmë se nuk ka dhunë në Dragash e unë them se ka, por që nuk paraqiten për shkak të arsyeve të ndryshme. Se duhet përkrahur këtë aktivitet-duhet, pasi se puna më e madhe kryhet në baza vullnetare, Ne si Kuvend duhet të organizohemi që ky Mekanizëm të funksionon sa më mirë dhe për këtë duhet t'a përkrahim këtë Plan, pasi se në të ardhmen, me siguri, do të ketë edhe linjën e vetë buxhetore nga niveli qendror e që nuk do të ketë nevojë për ndihmën tonë.

z.Velid Haxhisin- Unë desha vetëm një përmirësim reth përkthimit të këtij dokumenti ku thuhet te pozicioni i parë se shtypja e materialit nuk do të ketë shpenzime nga Komuna e Dragashit, që mendoj se është gabim gjatë përkthimit e që duhet përmirësuar, nga Gjilani në Dragash, e që duhet definuar se cili verzion është i drejtë. Ajo që mendoj është se Mekanizmi duhet të gjen mundësi të

njofton Kuvendin për realizimin e këtij Plani, që të identifikohet se sa ka përparime në pengimin e dhunës në familje, sa ka raste të pengimit të dhunës, sa janë përkuajdesur dhe a janë marrur me rastet ata që duhet të merren.

z.Nexhat Isufi- Shpesh kemi debatuar me inate, vetëm e vetëm se dikush është në pushtet, por ajo që është mirë, është mirë. Në një nga trajnime tona na është thënë se "kur të hynë në kuvend, librezën politike-partiake duhet t'a leni jashtë e që aty të hyni si qytetar dhe të punoni për qytetarë"! Në këtë rast, shuma e paraparë mos të hargjohet si mundet, por për rastet e pengimit të dhunës në familje dhe unë e përkrahi në tërësi. Për një projekt që ndahen 50 apo 100 mijë euro, ne duhet të përcaktohem për planifikim të mirë të projektit të tillë, që ne të jemi vend pa dhunë, me një strukturë të mirë e që pra projektet të realizohen me standarde e, aty ku ka dobësi në realizim të tyre, të reagojmë.

z.Samidin Xheladini- Ndoshta Plani ka gabime të caktuara teknike, pasi se në aktivitetet e vitit 2018 shkruan 30%, në 2019-500% e kjo, me siguri, paraqet "gabim teknik" e që duhet të ndryshohet.

Kryesuesi- Në rregull, të kalojmë në votim dhe kush është "për"-22, "kundër"-0 dhe 0 vota" të përmbajtura", që me këtë miratohet edhe ky Plan.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kalojmë në pikën e IV-të rendit të ditës-shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore të vitit 2018, hapim diskutimet...?

z.Valon Shabani-(DDEF-a)- Ne, si organizatë buxhetore, këtë P/Vendim e kemi bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësi, neni 30.2, ku thuhet se nëse Ministria merr arsyetime nga organizata buxhetore për transfer të mjeteve nga një kod ekonomik në tjetër kod, apo nga një kategori në tjetrën, të bëhet transferi i mjeteve, me kush që mos të tejkalohet shuma prej 15%. Në këtë rast ministri ka të drejtën që miraton këtë Propozim. Këtë Vendim ne e kemi paraparë për shumë arsye, kurse arsyeja kryesore ka qenë ka qenë disponimi i juaj që t'u ndihëmohej klubeve sportive, si dhe kemi edhe shumë kërkesa të qytetarëve që kanë statusin e personave në nevojë dhe me smundje të rënda. Ju e dini se mjetet për subvencione ishin, fillimisht, prej 22 mijë eurove e ato mjete janë hargjuar më së shumti për raste individuale e ata kanë qenë persona në nevojë për smundje të rënda e që kanë kërkuar mjete për të mbuluar shpenzimet e mjekimit. Prandaj, sot kemi qenë të detyruar të parashtrojmë këtë P/Vendim në Kuvend, për të marrë përkrahjen për të përcjell në MEF-a i cila presim se do të merret parasysh përkrahjen e Kuvendit tonë. Kjo shumë e paraparë për transfer prej 19,300,00 euro është nga kategoria e mallërave e shërbimeve nga DEF-a në të mirë të subvencioneve në Zyrën e Kryetarit.

z.Samidin Xheladini- Unë, personalisht, në takime tona kam kërkuar që të shtohet kjo kategori e subvencioneve në Zyrën e Kryetarit. Por, atëherë ish-kryetari e ish-kryesuesi na kanë bindur se nuk

mund të shtohet kjo kategori e Kryetarit të Komunës, se nuk paskemi të drejtën e transfereve dhe ndërrimin e kategorive buxhetore. Tanëi, nëse e paskemi këtë të drejtë ligjore, mua më vjen mirë se do të bëhet ky transfer. Këtë e theksoj se, nëse ka nevojë, të bëhen intervenime për nevoja të personave që vërtetë kanë nevojë dhe pajtohem që ky P/vendim të përkrahet, pasi se, vërtetë, ekziston numër i madh qytetarësh që kanë nevoja të ndryshme.

z.Laurat Krasniqi- Parimisht e përkrahi këtë P/vendim dhe, pasi se këtu është prezent drejtori, kërkoj sqarim, duke e pasur parasysh suficitin e Komunës me rastin e realizimit të investimeve kapitale e pyetja ime është se sa është e mundur se, kur bëhet tenderimi për projekt të caktuar, r të caktohet shuma se, për shkak të paraqitjes së ofertave me çmime më të larta, një shumë e caktuar po na shkon në suficit dhe a kemi atë të drejtë që këto mjete t'i riorjetojmë, pasi se kam dëgjuar se ka pësuar ndryshime ligji për mjetet që shkojnë në suficit, sidomos ato mjete që i përkasin suficitit për investime kapitale?

z.Valon Shabani- Siç theksova, kjo është edhe përgjigje në diskutimin e mëhershëm të delegatit se ne kemi insistuar për shtimin e kategorisë së subvencioneve, pasi se kemi pasur sukses dhe në bazë të iniciativave tona kemi arritur të shtojmë kategorinë e subvencioneve për periudhën vijuese në shumë prej 100%. Ndërkaq, këtë që theksoi parafolësi, reth bartjes së mjeteve të cilat shkojnë në suficit, kjo ka qenë e mundur vitin e kaluar vetëm atëherë kur kanë ngelur mjete që të orjentohej në projekt të ngjajshëm, nga e njejtja kategori buxhetore si psh. nga kanalizimi në ujësjellës, pra për të njejtën natyrë të punimeve e ju e dini se sezona e punimeve të ne është e shkurtër e për këtë mjetet po na shkojnë në suficit, dhe, për këtë, ne sivjet më herët kemi filluar realizimin e projekteve. Keni mundur të vëreni një ndalesë të punëve në terren për shkak të moskrijimit të pengesave me rastin e qëndrimit të diasporës sonë në vendlindje, por që, menjëherë, vërhet vazhdim i punimeve për të realizuar, siç duhet, investimet kapitale.

Kryetari- Drejtori dha sqarimet e nevojshme dhe të besojmë se ky P/Vendim do të na kalon në MEF-a. Ideja e iniciativës së këtill është se për organizata të caktuara sportive nuk po gjejmë mundësi tjera të finansimit e që kjo të mundësohet përmes subvencioneve, për aktivitete e tyre, dhe besoni edhe po të kishim edhe aq subvencione, ka nevojë për orjentimin e tyre, nga ase nevojat janë të mëdha për raste të ndryshme, siç janë finansimi i aktiviteteve sportive apo kulturore. Por, ajo që është më me rëndësi, shumicën e subvencioneve i hargjojmë për nevojat e qytetarëve në nevojë, për raste të shërimeve, për t'u solidarizuar, sado-pak, me pozitën e vështirë në të cilën gjenden të sëmurit. Pra, unë shpresoj se ky P/Vendim do të përkrahet nga MEF-a, për të pasur mundësi që të intervenojm për rastet që u përmendën.

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim dhe kush është "për"-23, "kundër"-0 dhe 0 vota "të përmbajtura", që konstatoj se miratum këtë P/Vendim...

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Në pikën e V-të kemi shqyrtimin dhe miratimin e Kërkesës së për Pëlqim Kompanisë “Vivawe-Gropu” (SHBA) për vendosjen e teknologjisë për prodhimin e energjisë me erë në f.Zgatar, hapim diskutimet, ku, fillimisht, fjalën e ka kryetari i Komunës z.Shaban Shabani.

Kryetari- Para nesh e kemi Kërkesën e kësak Kompanie të adresuar Kuvendit tonë e ata në Kërkesë, shkurtimisht, kanë përmendur se çka kërkojnë si dhe realizimin e projektit për instalimin e teknologjisë së re nga kjo fushë e nergjisë-me erë. Normalisht, për t’u realizuar ky qëllim i investuesit, të cilin ne e përgëtojmë, duhet të kalon nëpër procedura të caktuara tek institucionet përkatëse të kësaj fushe. Siç e keni në material, prona nuk është komunale por e Agjensisë Pyjore e që këtë e rregullon investuesi. Natyrisht, ky është investim i mirëserdhur dhe nevojitet edhe konsultime edhe me qytetarët e Zgatarit, ku menohet vendosja e asaj teknologjie në sipërfaqe prej 1.5 hektarë, e që menojmë se janë bërë dhe ka gatishmeri për realizim të këtij projhekti investues. Ky paraqet investim të amdh për Komunën tonë, efekte negative theksohet se nuk do të ketë realizimi i projektit, që mendoj se, ne-si Kuvend, duhet t’i papim Pëlqim paraprak për të vazhduar procedurata mëtejme investuesi, me dokumentacione përcjellëse, që duhet t’i suguron në ndërkohë, ashtu siç kërkojnë dispozitat lidhore e që kërkohen nga institucionet përkatëse. Me rëndësi është që ne, si komunë, mos të krijojmë bariera byrokrlike ndaj investuesit, pasi se jemi për realizim të investimeve në Komunën tonë.

z.Met Gashi (përaqësues i kompanisë “Vivawe-Group”)(SHBA)- Ju përshëndes dhe falenderoj për fjalën e dhënë dhe theksoj se unë jam qytetar i Republikës së Kosovës dhe njëherësh përaqësues i kësak Kompanie e cila merret me prodhimin e energjisë elektrike, përmes teknologjisë më të re-me erë, dhe theksoj se kjo iniciativë e Kompanisë është e para që po realizohet këtu në Kosovë e ne e kemi përfshirë pra Komunën tuaj për këtë investim fillestar.

z.Samidin Xheladini- E përshëndes përaqësuesin e Kompanisë i cili na prezntoi planin e Kompanisë e cila është e mirëserdhur për Komunën tonë dhe mbar Kosovën, pasi se kemi të bëjm me investim dhe, gjithësesi, duhet të përkrahim këtë iniciativë. Dëshiroj të informohem se a ka pasur matje të mëherhme të erës në f.Zgatar dhe se a jeni përcaktuar në bazë të matjeve për atë lokacion? Sipas Kërkesës, mund të përfundohet se fjala është për teknologji të avansuar e cila do të prodhon energji përmes erës dhe se në pyetje është investim i madh dhe na intereson të na sqaroni se a keni investuer edhe në komuna tjera, apo ne jemi të parët në këtë lëmi?

z.Laurat Krasniqi- E falënderoj investuesin i cili e ka përzgjidhur Komunën tonë për investimet e këtilla. Unë e kam lexuar materialin dhe kam ardhur në përfundim se ai nuk e ka Planin Biznesor dhe, duke pasur parasysh se elaboruesi i Kërkesës së Kompanisë është përaqësues legjitim i saj, e ne jemi përaqësues të popullit këtu, të kemi sa më shumë sqarime? Po theksoj se, edhe më herët, Komuna e Dragashit ka dhënë pëlqime të këtilla për prodhim të energjisë së ripërtrishme. Kemi pasur rastin e

ndërtimit të HC-ve, por që Komuna ka qenë përfituesi më i vogël. Prandaj, duke e pasur parasysh se ky është projekt i madh, por që nuk e ka studjimin paraprak të fizibilitetit, ne gjithësesi duhet t'i mbrojmë interesat e banorëve tonë dhe, nëse popullata lokale nuk ka interes nga kjo, atëherë ne nuk mund të japim Pëlqim, pa e marr pëlqimin paraprak të qytetarëve lidhur me këtë projekt? Kjo nuk do të thotë se ne jemi kundër investimeve, por që para kësaj kemi pasur reagime të qytetarëve, pasi kemi dhënë pëlqime për investime nga kjo fushë. Dhe, tani ne si Kuvend, nuk dëshirojmë që të ju biem në situata, si investuesit tjer, që të ju japim pëlqimin e pastaj të ballafaqoheni me probleme, apo që edhe qytetarët tonë të ballafaqohen me probleme. Për këtë, ekzekutivi i komunsë ka për obligim që, paraprakisht, të bisedohet me qytetarët e këtij lokaliteti e të merret pëlqimi i tyre lidhur me këtë investim? Ne, parimisht, jemi për investime dhe përkrahje të tyre, por materiali, që na është dërguar, nuk është plotësisht i bindshëm dhe, unë si ekonomist, mund të them se investimet e këtilla janë jo serioze nëse, paraprakisht, nuk e kanë përfshi edhe fizibilitetin?

z.Velid Haxhisin- Edhe pse është tërheqse kjo ide me investim 25 MgW energji elektrike - me erë, unë do të pajtohesh edhe me 10 MgW e që diçka të prodhohet nga kapacitet natyrore të ne. Ne kemi pasur rastim me HC-të dhe kemi pasur probleme të ndryshme në këtë drejtim e njëri nga problemet ka qenë se energjia e cila prodhohet nuk hyn në rrjetin e Dragashit, kështu që popullata lokale nuk mund t'a shfrytëzon atë dhe, edhe përkundër kapaciteteve ndërtuese, nuk kemi energji cilësore elektrike, të shoqëruar me defekte të shpeshta. Nuk di se në kompetencë të kujt është kjo që po theksoj-KEK-ut apo KOST-it, por për komunën tonë duhet të gjendet mundësia që të vendosen trafostacione që të shfrytëzohet si duhet energjia elektrike. Sidoqoft, edhe ky investim është i mirëseardhur dhe, siç dëgjuam edhe këtu, nuk paska ankesa të qytetarëve e që unë mendoj se ky investim do të jetë serioz, edhe nëse realizon edhe gjysmën e asaj që parashikon. Për mua, kapaciteti i energjisë 25 MgW më duket i madh dhe sipërfaqja e paraparë prej 1,5 hektarë, edhe pse nuk jam ekspekt për këtë, më duket e vogël, por ndoshta mos është në pyetje teknologji e avansuar e cila mund të prodhon këtë sasi të energjisë elektrike e kjo engjel obligim i Kompanisë e ne që t'a përkrahim iniciativën.

z.Rexhep Kamberi- Në emër të GIG-ut dëshiroj të përgëzoj iniciativën dhe përshëndes përfaqësuesit e Kompanisë që e kanë parashtruar këtë Kërkesë për realizim të Projektit. Pra, unë e përshëndes iniciativën dhe, ku të ishte fati të ishte paraqitur më herët iniciativa, ne në regjionin e Gorës nuk do të kishim problemet që i kemi pasur. Prodhimi i energjisë elektrike, përmes teknologjisë me erë, është çështje e mirë, si në aspektin e ambientit dhe në atë ekonmiko-prodhues dhe në mundësinë e punësimit të popullatës lokale. Do të votoj për këtë Propozim dhe do t'a përkrahi Kërkesën me Vendim dhe do të kisha lutur që, nëse ka mundësi Kompania, që iniciativa të njejta të paraqet edhe në trevën Gorës, pasi se besoj ka kushte klimatike për këtë çështje, si dhe kështu do të evitonim shkatërrimin e pasurive natyrore.

z.Zaim Hajredini- Më vjen mirë që të kemi investime të këtilla në Komunën tonë, pasi se Komuna është në gjendjen, siç është, duke pasura parasysh migrimin popullor këtu. Lidhur me këtë iniciativë, dua të theksoj se në kuadër të Planit Zhvillimor që e kemi votuar para 3 viteve, kur kemi paraparë investime me teknologji të këtilla, janë bërë edhe gjurmime lidhur me kapacitetet e erës e për çka edhe është bërë analizë e erës në lokalitete të Komunës sonë. Unë, si delegat i AKR-së, e përkrahi këtë iniciativë edhe nga fakti se lokacioni është investim i larguar nga vedbanimet e që është gjë e mirë, si dhe nuk do të ndikon negativisht në ambient e që do të ishte mirë që shtrihet edhe në lokalitete tjera të Komunës sonë. Obligimi i ynë është të japim Pëlqim, pasi se u kemi dhënë pëlqime edhe kompanive tjera të cilat kanë aplikuar për investime në lëmin e energjetikës.

z.Zinaida Elmazi- E përshëndes këtë Kërkesë, por për shkak të problemeve që kemi pasur, ne delegatët e mëhershëm me mini HC-të, do të kisha kërkuar nga investuesi që të na sjell edhe pëlqimin e qytetarëve, që pastaj mos të ketë probleme, si dhe ne-si delegat, pastaj mos me pas presione apo sulme nga mediat. Në mbledhjen e KPFinanca mora përgjigje se se vendosja e paisjeve do të jetë në pronë shoqërore e nuk ka probleme me parcela private e që ne psh.kemi pasur probleme lidhur me votimin tonë për vendosje të tradostacionit në fshatin Gllloboçicë, që e kanë shkaktuar qytetarët.

z.Vehbi Nazifi- Përshëndes investimet në Komunën tonë dhe, siç dihet, ne kemi përkrahur investimet, edhe pse disa nuk janë realizuar. Këtu kemi pasur Kompanin "Bushit" e cila kishte paraparë shifra milionëshe dhe s'dihet se deri ku u arrit?! Ky investues tani nuk ka kërkuar shumë sipërfaqe e që mendoj se nuk e meriton që ne-si Kuvend t'i paraqesim problem dhe mendoj se investuesi do të përfundon me sukses procedurat e mëtejme nëpër instanca më të larta.

z.Met Gashi- Kompania e së cilës jam përfaqësues unë e ka zbuluar këtë teknologji e cila është më përparuar në botë dhe teknologjitë tjera që kanë aplikuar janë nën këtë nivel që posedon kompania jonë. Për prodhimin e 10 MgW energji elektrike nga paisjet e "Vivawe-Group" nuk kërkohen shumë hektarë, por vetëm 1,5 hektar për prodhimin e 25 MgW energji elektrike dhe, nëse Kuvendi Komunal, na jep Pëlqimin, ne do të shtojmë kapacitetet dhe ne kemi vendosur që këtë teknologji, fillimisht, t'a vendosim në Kosovë e unë jam përfaqësues në kuptimin e promovimit të realizimit dhe planifikimit të projekteve dhe unë do të vazhdoj me promovimin dhe do të siell edhe projekte tjera të natyrës së ngjajshme, që varet nga ju? Pos prodhimin të energjisë elektrike, Kompania do të merret edhe me prodhim të ujit dhe nëse në komunën tuaj realizohet kjo teknologji ju do të jeni komuna më e sukseshme dhe do të keni shumë përparësi në ruajtjen e ambientit dhe në zhvillimin e turizmit, që do të shpeshohen duke i vizituar bukuritë e kësaj ane.

z.Laurat Krasniqi- Ju kisha lutur mos të ndiheni keqë, sepse edhe para jush janë paraqitur investues e të cilët kanë folur fjalë të mira sikurse ju tani, dhe kanë folur se do të hapin vende të reja pune dhe se komuna do të ketë energji elektrike e nuk ka asgjë nga ajo, dhe ju kisha lutur që këtë mos t'a kuptoni si personale.

z.Hajrudin Hoxha- Ne, në mandatin e kaluar, Kompanisë “Bushit” i kemi dhënë Pëlqim për investime në Komunën tonë dhe ju kisha lutur, përkatësisht organet ekzekutive, që të studjojnë mundësitë se mos, ndoshta, ka “konflikte interesi” në mes të planeve investuese në mes të kompanive. Ajo Kompani nuk është paraqitur gjatë tërë kohës për të shprehur interesimin për investime e në tërë territorin e komunës sonë ka planifikuar investime në shumë prej afro 600 milionë eurove dhe problemi qëndron që projektet, si ky të rëndësishëm për Komunën tonë, mos të stagnojnë?!

z.Met Gashi- Unë do të qëndroj në komunën tuaj, deri në ato momente kur të më largoni dhe, nëse do të vendosi këtë teknologji të re, do të vraponi pas meje.

z.Velid Haxhisin- Unë e kuptoni se ju keni politikë afariste dhe msheftësi afariste, por ne këtu, si Kuvend, duhet të kemi njohuri se si do të duket ajo teknologji dhe a jemi ne të parët të cilëve po na ofrohet ajo teknologji e zbuluar në Amerikë dhe se, para nga të gjitha vendet e Europës, do të arrin te ne?

z.Met Gashi- Ju jeni komuna e parë të cilës i ofrohet kjo teknologji në Europë dhe kjo teknologji nuk bënë zhurmë e madje nuk dëgjohet as miza?!

z.Nexhat Isufi- Ju lutem zotëri, ju jeni të mirëseardhur në Komunën tonë dhe ju pranojmë për investime.

Kryetari- Nuk kemi pasur mbledhje të rregullt, por sipas mendimeve që kemi marr nga banorët e Zgatarit, sidomos nga ata që jetojnë afër këtij lokaliteti ku parashihet montimi i tekonologjisë, lokacioni nuk është afër dhe nuk kemi pasur reagime të qytetarëve dhe mendoj se e kemi marr pëlqimin e tyre. Ne sot e miratojmë Pëlqimin parimor, se ne, si Komunë apo Kuvend, jemi të pajtimit për investime dhe pastaj ekzistojnë edhe 100 “filtra” tjer jër që duhet të kalon investuesi nëpër institucionet tona, që të dëshmohet se ky investim është në interes të komunitetit dhe nuk është në dëm të ambientit.

z.Samidin Xheladini- Sa i përket shqetësimit tuaj për investime, ju them se këtu keni 3-4 personalitete në Komunë e Kuvend që jan nga fshati im-Bresana dhe, nëse keni probleme në Zgatar, orjentonu për investime në këtë fshat e që do të ju përkrahim, me dy duar.

Kryesuesi- Mendoj se duhet të votojmë dhe kush është “për”-24, “kundër”-0 dhe 0 vota “abstenim”, që konstatoj se e miratuam Vendimin për dhënien e Pëlqimit kësaj Kompanie...

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë Formimi i Komisionit Komunal për themelimin e këshillave të reja të fshtrave, duhet të jetë 5 anëtarësh: 2 prej anëtarëve të Kuvendit, 1 nga ekzekutivi

i Komunës, 1 nga OJQ-të dhe nga 1 përfaqësues i fshatrave. Këtë detyrë duhet t'a bëjmë nga se, në të kaluarën dhe aktualisht, kemi probleme me funksionimin e këshillave lokale nëpër fshatra.

Kryetari- Fillimisht, ju njoftoj se Kuvendi e ka miratuar Rregulloren për bashkëpunim me fshatrat dhe, për të filluar me implementimin sajë, duhet të themelohet Komisioni Komunal i cili do të mbikqyrë procesin e themelimit të tyre dhe ngel në Kuvendin që të propozon anëtarët e vetë, kurse qëllimi kryesor këtu është bashkëpunimi më i mirë me fshatrat dhe shtimi i transparencës. Në ato fshatra, ku ekzistojnë këshillat e tyre, nuk ka nevojë të themelohen, por të bëhet verifikimi i tyre. Komisioni Komunal nuk do të ndikon në procesin e zgjedhjes së këshillave të fshatrave dhe me këtë rast e falënderoj OSCE-në që ka dhënë kontribut në këtë proces, ndërsa Komuna do të ofron kushte formale për punën e Komisionit me: transport, material etj.

z.Selman Osmani- Unë dje në KPFinanca kam theksuar se ky rast është moment historik për Komunën tonë, pasi se, deri tani, nuk kanë funksionuar këshillat e fshatrave dhe kanë qenë të formuar sipas linjave partiake. Prandaj, ky është propozim i mirë, që të dihen në tërësi të gjitha nevojat e fshatrave dhe këshillat janë më se të nevojshëm për nevojat e fshatrave. Pasi se unë jam nga Krushja, theksoj se atje, qe 10 vitet e fundit, këshillat kanë funksionuar nga partia politike e qytetarët tjer nuk kanë pasur qasje, sugjerime dhe propozime. Jan zhvilluar punime nga investimet kapitale dhe askush nuk ka dijtur asgjë dhe kush i kontrollon se kush kryen punime e janë bërë vetëm fotografi me firmat punëkryese dhe i kanë plasuar në medija, se ata po kryejnë punë dhe ndërtime! Ky Komision, që do të themelohet, të ketë kujdes nga eksceset e mundëshme, si dhe pyes kryetarin se a do të paguhet ky Komision?

z.Zaim Hajredini- Unë jam i lumtur që erdhëm deri te kjo situatë, pasi se kemi pasur shumë probleme e sfida nëpër fshatra, nga se këshillat nuk kanë funksionuar nëpër fshatra. Me këtë, këta këshilla do të lehtësojnë punën dhe do të ndihëmojnë reth realizimit të buxhetit të Komunës. Ndërkaq, kur është fjala te Komisioni, unë propozoj që partitë më të mëdha të propozojnë anëtarë-nga 2 pjestarë të komuniteteve tona.

z.Refik Latifi- Mendoj se themelimi i këshillave të fshatrave është me rëndësi të madhe, pasi se, përmes tyre, do të kemi qverisje më të mirë dhe transparencë dhe kjo është forma më e mirë e organizimit të punës në fshatra dhe bashkëpunimi i tyre me Komunën. Komuna, përmes këtyre këshillave, do të ketë qasje më të mirë nëpër fshatra edhe në realizimin e planeve investuese e këtu vjen në shprehje edhe planifikimi i investimeve dhe realizimi tyre, si, aktivitet kulturo-sportive, mbrojtja e mjedisit etj. Prandaj, duke e pasur rëndësinë e këtij Komisioni, ne si grup parlamentar (LDK) e përkrahim këtë hap dhe kërkoj që anëtarët të janë në harmoni me Rregulloren që e kemi në fuqi.

z.Nexhat Isufi- Po kalon qe një vit, prej kur kemi filluar të merremi me këto këshilla të fshatrave dhe konstatoj se, vërtetë, kemi nevojë për këto këshilla e sidomos kur kemi të bëjmë me parashikimet buxhetore. Psh. Ne e dijmë se në fshatin Blaç është arritur pajtushmeria për themelimin e Këshillit dhe

tani Komisioni Komunal a do të merret me mbikqyrjen e tij dhe s' di se si do t' a kuptojnë këshillat e fshtrave këtë Komision? Dhe, nëse janë zgjedhur dhe do të funksionojnë këto këshilla, duhet pasur parasysh faktin se përfaqësues të fshtrave duhet të thirren në Dragash e, s' paku, duhet paguar nga një kafe dhe a do t' u paguhet ndonjë shpenzime për këtë, pasi se ndeshen me sfida në fshat dhe a do të kanë far kompenzimi? Nëse kjo nuk llogaritet, do të jetë vështirë për të siguruar përfaqësues të fshatrave. Në ato fshatra ku nuk do të themelohen këshillat e tillë, duhet përdor metodën e njëfar sanksinimi se, nëse këtë nuk e bëjnë, ato fshatra do të përjashtohen nga investimet, pasi se ju nga komuniteti i fshatit konkret nuk po interesoheni për zgjidhje të këshillit i cili do të bashkëpunonte me Komunën reth buxhetit dhe çështjeve tjera. Unë po marr psh. një fshat-si Kukajani i cili merr investime nga Komuna e, në anën tjetër, nuk resepkton regullat Idhur me pastrimine ambijentit, duke ndotur ambientin dhe gjuajtur mbeturina dhe mos paguar shërbimin për pastrim. Po a shtu, pa dyshim, duhet parashikuar edhe faktin e një far pagese të përfaqësuesëve të fshatrave?

z.Vehbi Nazifi- Reth kësaj çështjeje mendoj se gjërat janë të qarta dhe mos të dalim nga rendi i ditës, pasi se tash më e kemi të miratuar Rregulloren dhe aty parashihet edhe pagesa. Më pëlqen propozimi që Komisioni të jetë e përbërë nga 2 anëtarë nga komuniteti shumicë dhe dy nga ai jo shumicë.

z.Samidin Xheladini- Ata njerëz që zgjedhen duhet të dijnë se me këtë i japin kotribut fshatit dhe duhet të dijnë se nuk paguhen, që do të thotë se në këshillat e fshtrave duhet të zgjedhen ata që kanë dëshirë e vullnet për të punuar, pasi se, deri tash, është punaur pa kompenzim e këtë duhet sqaruar këshillave, që, më vonë, mos të ketë paqartësi.

z.Granit Rifaj- Unë nuk do të futem në procedurë se a do të paguhen apo jo këshillat e fshatrave, por me rëndësi është që ata këshilla të themelohen dhe të funksionojnë, siç duhet. Në emër të GP (PDK-së) propozoj z.Sevim Avdullahi për anëtar të Komisionit Komunal.

z.Selman Osmani- Unë do të propozoja që Komisioni i këtill Komunal të jetë nga përfaqësues të të gjitha subjekteve politike?

Kryetari- Propozimi i parafolësit lësht pak i vështirë, pasi se se nuk mund të kyçen të gjitha subjektet politike në Komision. Nëse do të zgjedhim dy anëtarë të janë nga komuniteti jo shumicë dhe dy nga ai shumicë- pra 4 anëtarë nga Kuvendi, që mendoj se më praktike do të ishte të jetë Komisioni 7-anëtarësh: 4 nga Kuvendi, 1 nga ekzekutivi, 1 OJQ-të dhe nga një përfaqësues i fshtrave, kurse ata që do të zgjedhen po theksoj se nuk do të paguhen, por do të paguhen për pjesëmarrje në takime ku thirren për shpenzime me rastin e pjesëmarrjes në takime. Sa u përket verifikimeve të këshillave ekzistuese, do të ishte mirë që ata të janë prezent në takime dhe, me Procesverbal, të verifikohet numri i anëtarëve nga këshilli ekzistues , apo i riu.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe të propozoni kandidatët?

z.Selman Osmani- Falënderoj kyretarin për sqarime-2 nga komuniteti shumicë dhe 2 nga ai jo shumicë dhe unë propozoj, nga një, nga komuniteti Boshnjak e një nga komuniteti Goran dhe urdhëroni propozoni...

z.Hatixha Sheh- Më vjen mirë që sotë do të bëjm një hap të mirë në Kuvend për fshatrat. Më vonë do të shifen efektet se si do të punohet, kurse në emër të komunitetit Goran propozoj z.Selman Osmani.

z.Zinaida Elmazi- Nga komuniteti Boshnka propozoj z.Munir Jonuzi.

Kryetari- Nga ekzekutivi i Komunës propozoj z.Selmai Saiti-nënkryetar.

Kryesuesi- Në rregull, konstatoj se thmeluam Komisionin Komunal, në përbërje :z.Selami Saiti, z.Selman Osmani, z,Sevim Avdullahi, z.Samidin Xheladini, z.Munir Jonuzi, z.Jeton Qengaj dhe nga një përfaqësues i fshtrave dhe kush është "për"-20, "kundër"-0 dhe 0 vota "të përmbajtura", që konstatoj se zgjedhëm këtë Komision Komunal ...

Pika e VII (shtatë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën, urdhëroni, paraqituni në kadër të pikës së VII-të ku kemi rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01 Nr.060-11-9741/5..., hapim diskutimet...?

z.Samidin Xheladini- Neve, si Kuvend, nga secila seancë po na del nga një problem, duke na u kthyer vendimet tona nga administrata e pushtetit qendror-MAPL-ja. Për këtë, paraprakisht, duhet konsultuar-si Kuvend nga faktorët relevant-para votimit tonë dhe zyrtarët ligjor, për sqarime. Për këtë sqarime duhet të japin drejtoratet kompetent të ngarkuar me çështjet konkrete që i shqyrtojmë e pastaj të miratojmë, pasi se, vërtetë, po ndihemi keq kur po na këthehen vendimet tona e që po na sjellin në situata të palakmueshme. Pra, duhet vepruar që të deblokohen situata të këtilla. Ndoshta, në këtë seancë, është dashur të jetë prezent DDU, që të jep sqarime se pse erdhëm në këtë situatë dhe se si po lëshojnë vendime për leje, që ne si Kuvend, mos të jemi në situata para akteve të kryera.

z.Vehbi Nazifi- Unë jam i mendimit që ne, si Kuvend, duhet të qëndrojmë prapa këtij Vendimi që e kemi miratuar. Për këtë, mendoj se nuk e kemi shkëlur rregullat, pasi se kemi dhë vetëm Pëlqim paraprak dhe në këtë drejtim propozoj që drejtorati kompetent, në këtë rast DUrbanizmit, të merr gjërat në duart e veta e të vepron me respektimin e procedurave të mëtejme. Ne nuk duhet t'u krijojmë pengesa investimeve, për çka jam i mendimit se Vendimi duhet të qëndrosi i këtill, siç e kemi miratuar.

z.Selman Osmani- Unë pajtohem me diskutimin e kolegut-parafolës dhe me atë, që në të ardhën, kur lënda të silllet në Kuvend, të angazhohet shërbimi përkatës me çështjet konkrete para se të përcillen për në Kuvend. Në këtë rast drejtori i Katastrit të shqyrton se a kemi zonë për atë se çka kërkohet, pasi se, për këtë, po na ngjanë që po na këthehen vendimet e Kuvendit. E kemi edhe

Vendimin e MAPL-së lidhur me nënkryetarin e Komunës për komunitete, nga komuniteti jo shumicë, e që kërkoj më shumë detale nga kryetari?

z.Rexhep Kamberi- Unë edhe në seancën e kaluar, kur e shqyrtuam këtë Kërkesë, theksova se për këtë kompetent është DUrbanizmit dhe se problemet qëndron te PUrbanistik, pasi se kur të miratohet PUrbanistik, nuk do të kemi probleme të këtilla. Po ashtu, pajtohemi me atë që materiali, para se të arrijë në Kuvend, të analizohet nga ekspert të lëmisë e që këtu të kemi mendimin e tyre, pasi se të gjithë nuk jemi jurista apo ekonomista e gjeodetë, për të dijtuar çështje të këtilla. Ne këtu jemi përfaqësues të popullit dhe angazhohemi për investime dhe për ato votojmë dhe për këtë kemi votuar, siç kemi votuar dhe ky Vendim i ynë, të mbetet në fuqi.

z.Nexhat Isufi- Ne mbajmë të drejtën që ky Vendim të mbetet në fuqi, por a do të na këthejnë prap atë - ministritë e kjo po na ngjan, që disa herë dhe ne, faktikisht, nuk po dijmë se si të veprojmë, pos që t'a përkrahim, Vendimin tonë. Unë personalisht, jam në dilemë se a të përkrahi Vendimin tonë, për të cilën kemi konstatimin se është jo ligjor dhe si të përmirësojmë gabimin tonë që e paskemi bërë, sepse "nëse qenka ngrën pitja, tepsija është këtu" dhe si të veprojmë?!

Kryesusi- Nëse s'kemi diçka tjetër, kalojmë në votim dhe kush është "për"-17, "kundër"-0 dhe 1 votë e "përmbajtur", që, pra, Vendimi mbetet në fuqi.

Pika e VIII-të (tetë) e rednit të ditës – "eventuale"...

Kalojmë në pikën e VIII (tetë) dhe të fundit të seancës "eventuale", dhe, fillimisht, po përmendi kërkesën e mëhershme për sigurimin e "lap-topave" për delegatë e Kuvendit e , nëse pajtoheni, për këtë, duhet të miratohet Vendimi, urdhëroni...

Kryetari- Është fakt se delegatët kanë nevojë për verzionin elektronik të materialeve të seancave të Kuvendit e këtë e aplikojnë shumica e komunave të Kosovës e kjo është edhe në funksion të kursimeve materiale dhe shkarkimi nga obligimet shumëta që kanë zyrtarët e Shërbimit Komunal, si dhe përcjellja e materialeve në mënyrë adekuate dhe me kohë. Në shumicën e komunave, materiali i Kuvendit gjendet edhe në web-faqen komunale, si dhe dërgimi i tyre nëpër adresë elektronike të delegatëve.. Në bazë të llogarive me Zyrën e Prokurimit, për sigurimin "lap-topave" për delegatët nevoiten diku 15 mijë euro që do të siguroheshin nga kategoria e mallërave shërbimeve nga zyra e Kryetarit apo Zyra e Kuvendit. Pra, në ju ngel të miratoni Vendimin e pastaj të sigurohen kompjuterët "lap-top" me paisje të nevojshme edhe për Shërbimin Kuvendit, për këtë çështje.

Kryesuesi- Pra, kush është për miratimin e këtij Vendimi...? (Miratohet unanimisht).

Vazhdojmë me pikën "eventuale"-urdhëron...

z.Granit Rifaj- Kam një pyetje për kryetarin, pasi se kam dëgjuar se 5 fëmijë në f.Rrenc kanë, ngelur pa përkujdesen e prindërëve, pasi se e ëma e tyre qenka në spital e familja është në gjendje të

vështirë materiale për përkujdesje ndaj tyre. Pra, ata kanë ngelur pa përkujdesje dhe e pyes kryetarin se a ka ndërmarr diçka Komuna lidhur me këtë dhe a ka kontaktuar me QPSociale dhe cilat janë mundësi për ndihëmesë këtyre fëmijëve?

z.Munir Jonuzi- z.Kryetar, Ju e dini se KFOR-i turk është duke punuar në hapjen e rrugës Brod-Zlipotok e kam informata se qenkan vjedhur diku 400 l. naftë dhe më interesojnë informatat më detale lidhur me këtë rast?

z.Naser Myrtezani- Unë sot do të parashtoj 2-3 kërkesa të qytetarëve. E para, kemi folur për blerjen e paisjeve për Komunën, e në këtë kontekst mendoj në blerjen e një eskavatori i cili do të shfrytëzohej për pastrimin e rrugëve-sidomos dimërit, pasi se jemi mjedis maloro-kodrinor me lartësi të madhe mbidetare dhe vjen deri te bllokimi i rrugëve. Po ashtu, jemi në dijeni se sivjet, për mirëmbajtjen e rrugëve dimërit, do të nënshkruhet Kontratë me kompani private, por nuk është e tepërt që komuna të ketë edhe eskavatorin i cili do të shfrytëzohej për raste emergjente, nga se në pjesët e Komunës kemi fshatra të largëta e malore, si dhe si Komunë kemi pretendime të jemi komunë turistike e që ai do të shfrytëzohej edhe për hapjen e rrugëve për në bjeshkë? Kërkesa e dytë i përket kryetarit të Komunës dhe DKRSportit e kjo ka të bëjë me identifikimin e të gjitha rasteve të vrrarë dhe zhdukur nga viti 1998 e deri pas luftës, pasi se jemi në dijeni se ka raste që janë të mbytur dhe të zhdukur e nuk kanë qenë veteranë të luftës dhe kërkoj që, në kuadër të këtij Drejtorati, të inicohet kjo çështje e verifikimit të rasteve të tilla e që kjo të merret në konsideratë, për të mos u zhdukur një pjese e hirstorisë sonë. Këtë e kërkoj nga kryetari që të inicohet procedura e këtillë dhe, nëse ka nevojë, të thmelohej edhe Komisioni i cili do të identifikonte të gjitha këto raste e lidhur me këtë të ngritet një pllakë përkujtimore e cila do të vendosej në vendin e caktuar, që edhe atyre t'u vendosen kurora lulësh në shenjë përkujtimi? Po theksoj edhe këtë se, pasi se këtu e kemi edhe drejtorin e DKArsimit, i dëshiroj fillim të mbar të vitit të ri shkollor, por ka vërtetje në punën e drejtorit, theksoj, si delegat i Kuvendit dhe punëtor i arsimit. Unë, edhe pse personalisht jam i kënaqur me punën dhe angazhimin e drejtorit të Arsimit dhe me shënimin e festave, do të isha edhe më i kënaqur, po ta shoh drejtorin edhe në vizita institucioneve arsimore me rastine fillimit të vitit shkollor, që të viziton shkollat dhe të interesohet me brengat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen personeli arsimor. Edhe pse personalisht jam i kënaqur me punën dhe angazhimin e drejtorit të Arsimit dhe me shënimin e festave, do të isha edhe më i kënaqur, po ta shoh drejtorin edhe në vizita institucioneve arsimore me rastine fillimit të vitit shkollor, që të viziton shkollat dhe të interesohet me brengat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen personeli arsimor, pasi se është më ndrshe nëse do të bindeshit vetë se sa të ju informon dikush. Po ashtu, drejtorin dëshiroj t'a përgëzoj për disa hapa konkrete lidhur me arsimin e në rastin tim konkret, që kam punuar shumë vite në arsim me normë jo të plotë, tani, në mandatin e drejtorit aktual, jam mësimdhënës me orar të plotë. Ndoshta, kjo ka qenë pasojë e përcaktimeve politike, por sidoqoft, tani në shkollën e Bresanës, të gjithë mësimdhënësit, për herë të parë, punojnë me normë të plotë mësimore. Prandaj, mund të them, sipas konstatimeve të shumë njerëzëve, se situatat në arsim, këtë vit, apo në këtë mandat të drejtorit, është shumë më e mirë se në periudhat e mëhershme.

z.Samidin Xheladini- Kryetari është në dijeni, por gjithsesi dëshiroj të parashtoj pyetje lidhur me ndërtimin e urës në Bresanë, ku një numër banorësh kanë probleme, pasi se ura nuk është ndërtuar siç duhet e tani uji është orjentuar kah shtëpit e tyre që janë afër urës? Po ashtu, lidhur me tregun i cili mbahet në në Bresanë, se a është e mundur që mos të parkohen automjetet në oborrin e shkollës, si dhe një informatë (që është dëgjuar edhe përmes "Radio-Sharrit"), apo është propagandë, se tenderët po u jepen atyre që bëjnë fushatë politike në interesin tuaj? Gjithashtu, flitet se tenderë të caktuar u besohen edhe atyre që nuk janë fare prezent-fizikisht, që besoj se, "Radio Sharri", qëndron prapa këtyre konstatimeve?! Të shqyrtohet edhe mundësia e vendosjes së hidrantit në fshatin Bresanë, që Shërbimi i Zjarrfikësve të jetë në gjendje të furnizohet me ujë, në raste të zjarreve?

z.Arjeta Skeraj- Kam një pyetje për drejtorin e Arsimit dhe nxënësve e mësimit ju dëshiroj fillim të mbar të vitit shkollor e pyetja ka të bëjë se a ka informata se një numër i caktuar nxënësish në shkollën e mesme në Dragash e vijon mësimin e , në realitet, e që nuk kanë një e madje edhe dy prindër dhe parashtrohet pyetja se a mund DKArsimit, që ktyre rasteve, t'u ofrohet mundësia e lirit nga pagesa e transpaortit, duke pasur parasysh situatën e tyre ekeonomike? Edhe një pyetje për kryetarin e Komunës, pasi se ka filluar viti i ri shkollor, a janë hapur të gjitha shkollat dhe a janë funksionale paralelet parashkollore, apo ka shkolla të caktuara të cilat janë të mbylluar apo janë duke u rinovuar?

z.Vehbi Nazifi- Pasi se jemi në prag të miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, parashtoj pyetjen se a ka mundësi që parashihet edhe një segment i projektit-ndërtimi i trotuarit në realacionet Zym-Bellobad dhe Buzez-Bresanë, pasi se janë destinacione të rrezikshme për nxënës? Po ashtu, edhe tregu në Bresanë të përcaktohet orari i mbajtjes së tregut e që, pas këtij orari - që caktohet, të lirohen rrugët, pasi se kemi rastet se gjatë tërë ditës kamionat me mallëra qëndrojnë aty para shitoreve të cilat shesin të njëjtin mall?

z.Nexhat Isufi- Edhe unë do t'i drejtohem drejtorit të DKArsimit dhe i uroj vitine ri shkollor. Por, duke pasur parasysh se tash më e votuam Planin Transparencës, parashtoj pyetjen se sa ka qenë transparent procesi i konkurimit në arsim, a keni pasur ankesa dhe kërkesa dhe a u keni këthyer përgjigje atyre që janë ankuar? E dyta, në emër të transparencës, në konkurset që do të hapni, të vendosni edhe emrin e kandidatit që do të pranohet në punë e kjo është transparencë! Të paktën, të kemi fëshmi e njohuri lidhur me pranimin në punë të atyre që pranohen?!

Kryetari- Në disa pyetje të parashtruara lidhur me arsimin, përgjigje dha DDKA-së. S i përket pyetjes e cila ka të bëjë për familjen me fëmijë në përkujdesje, mund të them se kemi kontaktuar me QPSociale dhe në pyetje është familja me 5 fëmijë dhe nëna e tyre, momentalisht, është sëmurë dhe gjendet në Spitalin Rajonal të Prizrenit. Duke e pasur gjendjen e kësaj familje, se nuk është në gjendje që vetë të përkujdeset, ne e kemi marr obligimin e përkujdesjes dhe, çdo ditë, zyrtarët e QPSociale e vizitojnë këtë familje, pasi se kemi marr për obligim të furnizohen me shujta ditore në kuadër të mundësive. Z.Fadil Reshiti nga QPSociale është personi i cili merret me këtë çështje dhe ne jemi

obliguar se, për deri sa nëna të gjendet në spital, të përkujdesimi për këtë familje. Lidhur me pyetjen reth punëve që kryhen nga KFOR-i Turk, i cili vullnetarisht punon në hapjen e rrugës në mes të dy fshatrave, situata ka qenë e pa pranueshme dhe na ka prurë në situatë të palakmueshme e janë vjedhur 400 litra naftë dhe nuk jemi ndier fare mirë për këtë që ka ndodhur?! Ne jemi angazhuar se, nëse ka nevojë, të angazhohet në rojtar nate, si dhe që patrullat policore të shpeshtojnë lëvizjet tek zona e punimeve, si dhe kemi kompenzuar naftën e vjedhur. Kjo ka qenë ajo që kemi mundur të veprojmë në Komunë. Z.Naser M. ka propozuar blerjen e një eskavatori dhe ne vërtetë gjatë sezonit dimëror ballafaqohemi me orteçe të mëdha bore dhe situata të vështira në rrugët e fshatrave tona dhe jemi në fazën përfundimtare tenderuese të dhënës së rrugëve për pastrim ndonjë kompanie private. Nga mekanizmi që posedojmë ne, shumica e tyre janë jo funksionale për pastrimin e rrugëve, në tërësi dhe presim angazhimin e kompanisë private. Por, kjo nuk do të thotë se kërkesa e z.Naser nuk është e pranueshme, nga se ne kemi nevojë për një makineri të tillë dhe mendoj se këtë duhet t'a kemi si obligim. Kjo çështje mund të jetë edhe si obligim me rastin e planifikimeve të ardhshme buxhetore. Po ashtu, kërkohet edhe verifikimi i personave që ranë viktimë gjatë luftës, që mendoj se do të ishte më serioze të angazhohet ndonjë Komision profesional, qoft edhe jasht Komunës, me kualifikime e njohuri të nevojshme për këto çështje, qofshin ato edhe OJQ e që do të kemi mundësitë e pagesës së projektit të tillë e ndoshta edhe z.Naser M, personalisht, mund të jep kontributin, përmes bashkëpunimit me ekspert në këtë fushë e që, gjithsesi, do të keni përkrahjen e qeverisë lokale, si dhe fakti se, në mesin e tyre, nuk kishte veteranë të luftës e ne të tillët nuk guxojmë t'i harrojmë. Sa i përket ndërtimit të urës dhe derdhjes së ujit në vende të caktuara, nëse dëshirojmë që të merremi seriozisht, personat e goditur nga kjo do të ishte e rendit të paraqiten edhe me një Kërkesë, që operatori ekonomik të merrej më seriozisht me shqetësimet e tyre. Ne të cilët e dijmë atë terren e dijmë se nuk mund të realizohet më mirë se siç është punuar. Sa i përket tregut në Bresanë, çështja është e ndieshme, pasi se ata që kanë lokale dhe ata që vijnë për shitje sduhet të kenë mirkuptim reciprok, kurse, siç dihet, ai treg, nuk është zyrtarisht i regjistruar - si treg, por nuk ka problem që të ndërmerren masa të caktuar përmes Inspektionit për të bërë sistemimin e pjesëmarrsëve në shitje atje, kurse ideja që ai treg të funksionon, me orar, është çështje e pranueshme dhe ide e mirë.. Çështja se tenderët po u jepen kompanive të caktuara që përkrahin fushatat zgjedhore kjo është dukuri dhe realitet se partitë politike kanë sponsorët e vetë dhe unë nuk jam i sigurt për cilën parti është fjala? Por, theksoj se të gjitha ato firma që konkurojnë janë të regjistruara dhe i plotësojnë kushtet e konkurimit, kurse, siç dihet, tenderin e marrin ato kompani të cilat ofrojnë çmimin më të ulët e këtu nuk mund të ndërmarrim shumë, nga se kështu janë procedurat tenderuese dhe, e them me përgjegjësi, se tenderët nuk i marrin ato kompani që janë sponzore të fushatave zgjedhore. Te vendosja e hidrantëve, kjo mendoj se është ide e mirë dhe se kjo mund të merret parasysh me projekt që do të realizohen në të ardhmen reth rrjeteve të ujësjellësëve dhe pse auto-cisternat e Shërbimit të Zjarrfikësëve të vijnë në Dragash, kur mund të furnizohen nga hidrantët në terren. Sa u përket rregullimit të trotuarëve në mes të këtyre dy fshatrave, mendoj se është ide e mirë, por meqenëse kjo nuk është përmendur në propozimin e buxhetit, kërkesa mund të evidentohet si mundësi me rastine miratimit final të buxhetit të Komunës.

z.Vloran Cenaj (drejtor i DKArsimit)- Kishte disa pyetje në emër të DKArsimit e pyetja e parë ishte lidhur me vizitat nëpër shkolla e që, ne si Drejtorat këto vizita i kemi bërë, siç i kemi bërë përgatitjet për fillim të mbar të vitit të ri shkollor. Nuk jemi marr vetëm me çështje teknike, por edhe me përgatitje profesionale për fillim të mbar të mësim. Pyetja se pse nuk i kemi vizituar të gjitha shkollat më 3 shtator, kjo ka qenë për shkak të angazhimeve të mëdha që kemi pasur me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor e nuk kemi mundur t'i vizitojmë të gjitha shkollat. Por, këtë e kemi bërë ditën e nesërme, duke vizituar shumicën e shkollave dhe do t'i vizitojmë edhe ato shkolla që kanë ngelur pa u vizituar. Këto vizitat tona nuk do të jenë vetëm me fillimin e vitit të ri shkollor, por do të janë të vazhdueshme gjatë periudhave të ndryshme kohore të vitit shkollor. Sa u përket pyetjeve luidhur me ankesat lidhur me konkursin dhe procedurat e punësimit, në këtë moment mund të theksoj se, deri tani, kemi pasur 3 kërkesa-ankesa të tilla. Secili kandidat i cili e ka dhënë testin, me shkrim, është ftuar në test me gojë dhe këtë e kemi bërë në harmoni të plotë me Ligjin e Arsimit të Kosovës. Ligjet në fuqi dhe UA e japin të drejtën që secilit parashtrues të kërkesës-ankesës, që nëse DKA nuk jep përgjigjer, të paraqiten në Departamentin Rajonal të Inspektoratit të Arsimit në Prizren, nëse ne kemi shkelur të drejtat dhe procedurat e konkurimit e që, me siguri, do të përkrahim e zbatojmë mendimet e këtij Inspektorati. Ndërkaq, lidhur me transparencën e proceseve tona, unë theksoj se, gjatë mandatit tim, në tërësi zbatohet Ligji ui Arsimit dhe të gjitha UA-ve dhe aktet tjera nga lëmia e arsimit e në këtë të jeni të sigurt.

z.Nexhat Isufi- S' di se a a jeni në dijeni z.drejtor se nga Drejtorati juaj, më herët, është larguar nga pozita drejtori, për shkak të menaxhmit të dobët dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare?

z.Vloran Cenaj- I nderuar përfaqësues i popullit, unë nuk merrem me të kaluarën, por jam përgjegjës për periudhën që jam përgjegjës për pozicionin që kam. Në bazë të shënimeve zyrtare në terren, të gjitha institucionet e arsimit e kanë filluar procesin mësimor. Me Ligjin për Arsimitim Parauversitar dhe me UA-e ne e bëjmë pagesën e transportit për nxënësit që janë 5 km. larg shkollës, kurse reth arsimimit të mesëm, nuk e kemi këtë të drejtë për mbulesë të shpenzimeve, por gjithsesi se do të shqyrtojmë mundësitë, duke pasur paarsysh rastet specifike dhe në bazë të mundësive buxhetore, edhe atyre t'u ndihëmohet, aq më tepër, nëse Kuvendi miraton ndonjë Vendim të tillë, me të cilin do të na përkrah e kjo do të ishte edhe më mirë. Ne, gjithsesi, do të ndihëmojmë, me të gjitha mënyrat, sidomos nxënësit që janë ndryshe nga të tjerët.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu